

KORRUPSIONIT DUHET T’I RRËMBEHET E ARDHMJA!

*nga Fatos ÇOÇOLI¹ – Ekspert i Jashtëm,
botuar në gazetën “Koha Jonë”, më 17 shkurt 2015.*

Sado denoncime online të marrësh, sado portale kundër korrupsionit të krijosh, je në periferi të luftës së vërtetë. Pse korrupsioni është si një kuçedër, që sado koka të presësh, gjithnjë dalin të tjera edhe më të shumta. Korrupsioni kufizohet dhe mbahet nën kontroll vetëm me luftën në sistem dhe me goditjen nga rrënjët, aty ku ai lind. Lufta preventive, parandaluese është arma më e aftë për të goditur korrupsionin, për t’i rrëmbyer të ardhmen atij! Qeveritë e vendeve të ndryshme hartojnë strategji dhe programe të veçanta për luftën kundër korrupsionit. Vihet re, jo vetëm në rastin e Shqipërisë, se shumë qeveri tentojnë të anashkalojnë forcën dhe incizivitetin e punës së organeve të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm publik të financave publike, në garën për të rrëmbyer sa më shumë pikë në strategji e qasje kundër korrupsionit. Mirë po korrupsioni goditet në zemër të tij, vetëm në rastet kur luftohet gjeneza nga lind, kushtet që e bëjnë të lulëzojë. Vetëm parandalimi, llogaridhënia dhe transparencja, që janë asetet kryesore të



integritetit të një institucioni shtetëror, mund të hyjnë në zemrën e korrupsionit si “kancer” dhe ta mposhtin atë. Pse korrupsioni ka aq shumë koka, sa, sado koka t’i presësh, ai sërish lulëzon e zhvillohet. Këtë qeveria e sotme duhet ta ketë të qartë. Me gjithë përpjekjet e saj, strategjia e re anti-korrupsion, hapja e një faqeje në internet për të denoncuar veprimet korruptive, ndjeshmëria e shqiptarëve se shteti ynë është i krimbur në korrupsion do të vijojë, përderisa ai nuk do të luftohet nga rrënjët. Dhe rrënjët duhen gjetur në të gjitha institucionet publike, të cilat duhet të fillojnë katarsisin e vërtetë, pastrimin nëpërmjet instrumentit të integritetit. Por lind pyetja: kur quhet një institucion me integritet?

Integriteti nuk është një koncept i thjeshtë për t’u përcaktuar. Ai i referohet virtytit, etikës publike, mos korruptimit dhe gjendjes së të qenit i papërlyer. Kontrolli, auditimi i tij është një sfidë e veçantë, por thelbësore për një institucion publik. Prej kësaj nis lufta më efiçente dhe e plotë kundër korrupsionit, pse e godet atë në fillimet e tij. Një program shumë i mirë vetëvlerësimi të integritetit (i quajtur IntoSAINT) është zhvilluar nga Gjykata Holandeze e Auditimit, në vitin 2012. Ndonëse ky program ju adresua fillimisht institucioneve të auditimit suprem (ndërmjet të cilave dhe KLSH), ai vlen për çdo institucion shtetëror. Kontrolli i Lartë i Shtetit u njoh me programin IntoSAINT në vitin 2012 dhe vendosi zbatimin e tij. Periudha deri në fund të vitit 2013 ishte periudhë e njohjes më të thelluar të Programit dhe e vlerave të tij. Gjatë vitit 2014 dhe këtë vit, institucioni po provon vetëvlerësimin e integritetit të vet, me ndihmën e organizatave të shoqërisë civile, ndër më seriozet e të angazhuara në luftën për transparencë dhe kundër korrupsionit. KLSH është i ndërgjegjshëm për problematikat e

integritetit në radhët e audituesve të tij dhe se i ngelet shumë punë për të realizuar integritetin e plotë në institucion. Por të paktën, ai e ka nisur vetëvlerësimin e integritetit brenda vetes. Gjatë tre viteve 2012-2014, KLSH ka synuar një ekuilibër mes parandalimit të shkeljeve dhe marrjes së masave ndëshkimore nga njëra anë, dhe inkurajimit të vlerave të integritetit tek kontrollorët e vet, nga ana tjetër. Në këtë institucion është çrrënjësuar praktika e mos ndëshkueshmërisë, gjë që e gjen rrallë në institucione të tjera shtetërore. Për çdo shkelje të integritetit, të zbuluar dhe hetuar, janë ndërmarrë masa ndëshkimore deri në ndjekje penale për ish-kontrollorë. Kjo qasje duhet kërkuar me forcë nga qeveria jonë qendrore, por dhe nga pushteti vendor, që të kryhet e plotë në strukturat e tyre. Institucionet shtetërore më të rëndësishme të Shtetit, nga ministritë deri tek drejtori qendrore, bashki dhe ndërmarrje publike në formën e shoqërive aksionere, ku luhen me dhjetëra miliona euro para të taksapaguesve shqiptarë dhe ku, nga shkeljet e abuzimet, edhe dëmi ekonomik është po ashtu në nivele miliona euro, duhet të njihen dhe në mënyrë taksative ta zbatojnë instrumentin e vetëvlerësimit, procesin dhe programin IntoSAINT. Në luftën kundër korrupsionit janë të përfshira në front të parë institucione të posaçme si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Prokuroria, Departamenti i Parandalimit të Krimin Ekonomik, Departamenti i Parandalimit të Pastrimit të Parave, Policia e Shtetit, etj. Të gjitha këto institucione duhet ta njohin dhe përvetësojnë teknikën e programit IntoSAINT. Asnjë institucion shtetëror nuk është në gjendje të luftojë me eficiencë korrupsionin, në rast se me një proces transparent dhe korrekt vetëvlerësimi, nuk del me integritet të lartë për vete. Korrupsioni përfaqëson rrezik serioz për parimet dhe vlerat bazë të Bashkimit Evropian ku duam të

futemi. Ai minon besimin e qytetarëve tek demokracia, gërryen shtetin ligjor, përbën mohim të të drejtave të njeriut dhe pengon zhvillimin normal shoqëror dhe ekonomik të Shqipërisë. Nëse nuk i gjejmë “ilaçin” apo “kancerin” kësaj dukurie shkatërruese, do të jemi gjithnjë në trenin e fundit dhe asnjëherë anëtar me vlera të Evropës së Bashkuar. Niveli i lartë i indiferencës dhe mungesës së besimit të qytetarëve në institucione është shkaktuar nga një qeverisje pa llogaridhënie, transparencë dhe përgjegjshmëri. Këto vlera një institucion si Kontrolli i Lartë i Shtetit po përpiqet fort t’i kthejë në nivelin e duhur në institucionet publike që ai auditon (praktikisht të gjithë ngrehinën e Shtetit dhe qeverisë), por i vetëm ai nuk mund të arrijë rezultatet që presim të gjithë si qytetarë. Nëse shoqëria civile dhe opinioni publik bashkohen me të dhe rrisin kërkesën e llogarisë, edhe Kuvendi e qeveria do të mund të kenë ndër duar instrumentin “vrasës”, “kancerin” e korrupsionit, procesin që e rikthen të plotë integritetin në moralin dhe mjedisin tonë publik.

¹ Shkrime të tjera të botuara nga Fatos ÇOÇOLI për periudhën janar–qershor 2015:

- *Një buxhet më i hapur na përmirëson jetën.*
(Botuar në gazetën “Shqip”, më 19 qershor 2015.)